



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 7100/prot.

Himarë, më 25.11.2024

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

BANORËVE TË KOMUNITETIT TË HIMARËS DHE GJITHË PALËVE TË INTERESUARA

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" në nenin 9 pika 1, 3, të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18, si dhe në Rregulloren e Këshillit bashkiak "Për konsultimet publike", ligj nr. 41/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, v.k.m-se nr.377, datë 12.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar; Vendim nr. 694, datë 2.10.2019 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.686, datë 22.11.2017, të Këshillit të ministrave, "për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar;

Ju njoftojmë se do të zhvillohet dëgjesa publike në kuadër të:

- **RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË HIMARË, MIRATUAR ME VENDIM TË K.K.T –SË NR.2 DATE 16.10.2017, I RISHIKUAR ME VENDIM NR.5 DATË 10.06.2020, VENDIM NR.5 TE K.K.T –SE DATE 15.04.2021, VENDIM NR.2 TE K.K.T-SE NR.2 DATE 25.04.2023.**

Ftojme Këshillin bashkiak Himarë, Kryetarin e bashkise, Kryetaret e fshatrave respektive, banoret e interesit, të gjithë grupet e interesit, të rinj/të reja, etj të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Takimi do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 16.12.2024

Ora: 10:00

Vendi: Salla "Neço Muko", Himarë

Këto takime kanë si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve dhe mendimeve tuaja mbi këtë çështje.

Gjithashtu mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete të cilat mund të dërgohen në adresat e mëposhtme të e-mailit:

- Koordinatorin për të drejtën e informimit: erindhabili@himara.gov.al
- Adresa zyrtare e bashkisë Himarë: info@himara.gov.al

Këto dëgjesa publike do të zhvillohen në bashkëpunim me bashkinë Himarë dhe anetëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është e rëndësishme.

KRYETAR I BASHKISË

Vangjel Tavo

